



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 64, paragrafit 2, nën paragrafëve 2.1 dhe 2.2, neneve 16,17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) neneve 9.2, 13, 14, 20 dhe 29.2 të Ligjit nr. 03/072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL) dhe nenit paragrafit 1 të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/1-122 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058 (LFSP), me datën 06.03.2024, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE NR. 04/2024

CERTIFIKIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE DHE I KANDIDATËVE TË TYRE

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton procedurat për aplikimin dhe certifikimin të subjekteve politike dhe kandidatëve, kriteret për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre, arsyet e refuzimit të kërkesës për certifikim, ankesat e aplikuesve për certifikim, shqyrtimin e aplikacioneve, tërheqjen apo zëvendësimin e kandidatëve të subjekteve politike, ruajtjen dhe verifikimin e të dhënave të tyre, pagesën e certifikimit dhe renditjen në fletëvotim.

Neni 2

Aplikimi për certifikim i subjektit politik dhe kandidatëve të tyre

1. Partia politike e regjistruar, është automatikisht e certifikuar por, duhet ta njoftojë Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga deklarimi i datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës për çfarëdo ndryshimi për kryetar të partisë, përfaqësues të autorizuar të partisë, ose përfaqësuesit financiar të partisë.
2. Pas përmbushjes së kërkesave sipas paragrafit 1 të këtij neni, partia politike e regjistruar do të jetë automatikisht e certifikuar, përveç nëse Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) konfirmon se një parti politike nuk i ka paguar gjobat e shqiptuara në zgjedhjet paraprake apo ndonjë detyrim tjetër, përfshirë këtu edhe gjobat e shqiptuara nga KQZ apo është

sanksionuar sipas nenit 15 të Rregullores Nr. 01/ 2024 Regjistrimi dhe Funkcionimi i Partive Politike.

3. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga shpallja e datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës së Kosovës, partia politike e regjistruar deklaron mos pjesëmarrjen në zgjedhje duke e njoftuar Zyrën, apo që partia politike do të kërkojë certifikim përmes koalicionit, në përputhje me ligjin.
4. Subjekti politik që synon të garojë në zgjedhje për Kuvendin e Kosovës, kuvende komunale dhe kryetarë të komunave, duhet të aplikojë për certifikim në KQZ. Subjekti politik duhet ta dorëzojë dokumentacion në Zyrë gjatë orëve të rregullta të punës, jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë para zgjedhjeve.
5. Secili aplikim për certifikim të subjektit politik duhet të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, që përmban informatat e mëposhtme dhe formularin e plotësuar të kërkesës për certifikimin të subjektit politik, i cili është bashkëngjitur si Shtojca I - Kërkesë për certifikim të subjektit politik, i cili përmban:

5.1. emrin dhe akronimin e subjektit politik;

5.1.1. në rast të koalicionit partitë politike të regjistruara mund të zgjedhin një emër të përbashkët të koalicionit apo emrat e të gjitha partive politike që janë pjesë e koalicionit.

5.2. zgjedhjet në të cilat subjekti politik garon, dhe në cilat komuna;

5.3. certifikatën e regjistrimit për partinë politike të regjistruar;

5.4. kopjen e letërnjoftimit dhe numri personal në rastin e kandidatëve individual;

5.5. emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit të kryetarit të subjektit politik, ku kjo është e zbatueshme, e personit kontaktues dhe e përfaqësuesit financiar, dhe numri i telefonit të zyrës qendrore të subjektit politik;

5.6. të dhënat sipas paragrafit 5, nën paragrafi 5.5 të këtij neni, për partitë politike të regjistruara në Kosovë, që duhet të përputhen me të dhënat sipas përditësimit të fundit të dorëzuar në Zyrë;

5.7. logoja zyrtare e partisë, apo në rast koalicionesh, logoja e të gjitha partive politike që janë në koalicion, apo çfarëdo logoje të vetë koalicionit;

5.8. emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit i përfaqësuesit financiar të subjektit;

5.9. emri, mbiemri, adresa, numri i telefonit dhe email-adresa e personit kontaktues;

5.10. çdo subjekt politik duhet që, në aplikimin për certifikim, të nënshkruajë deklaratën politike, Shtojca VIII - Deklarata politike, të nënshkruar nga kryetari apo personi i

autorizuar i subjektit politik, dhe është në përputhje me kodin e mirësjelljes, Shtojca VII - Deklarata për respektimin e Kodit të Mirësjelljes dhe LZP;

5.11. në rast të koalicionit, një deklaratë e nënshkruar nga kryetari i secilës parti politike të regjistruar e cila merr pjesë në koalicion përmes së cilës jepet pëlqimi për të marrë pjesë në zgjedhje përmes koalicionit dhe që zotohen për të respektuar dhe vepruar në pajtim me Kodin e Mirësjelljes së këtij ligji, shtojca III - Formulari i pëlqimit të koalicionit;

5.11.1. pjesë përbërëse e aplikimit për certifikim të koalicionit, do të jetë edhe lista e kandidatëve të koalicionit që duhet të përmbajë informatën e saktë mbi numrin e kandidatëve të secilës parti politike që është pjesë e koalicionit, duke shënuar përkatësinë partiake të secilit kandidat në listë, shtojca IV – Lista e kandidatëve të koalicionit (forma fizike dhe elektronike).

5.12. në rastin e nismës qytetare, numrin e letërnjoftimit të udhëheqësit të nismës, përfaqësuesin e autorizuar dhe përfaqësuesin financiar. Në rast të kandidatit të pavarur apo nismës qytetare, kandidati apo udhëheqësi i nismës po ashtu mund të shërbejë si përfaqësues i autorizuar dhe përfaqësues financiar;

5.13. subjekti politik në aplikimin e vet tregon nëse dëshiron të hyjë në garë për Kuvendin e Kosovës, për të fituar ndonjërin prej vendeve të garantuara për përfaqësim të komuniteteve tjera jo shumicë të Kosovës, sipas nenit 64 të Kushtetutës.

5.14. listën e kandidatëve të subjektit politik për secilin proces zgjedhor në të cilën garohet, e cila është bashkëngjitur, shtojca V - Lista e kandidatëve të subjektit politik, të shtypur dhe të nënshkruar nga kryetari i subjektit politik ose personi kontaktues, si edhe në formën elektronike siç përshkruhet në në këtë Rregullore;

5.15. formularin i aplikimit për certifikim të kandidatit, shtojca VI - Formulari për aplikim për certifikim të kandidatit.

6. Subjekti politik duhet të përgatisë një bazë elektronike të të dhënave, e cila i dërgohet Zyres dhe e njëjta përmban të dhënat si në vijim:

6.1. emrin, mbiemrin, gjininë dhe datën e lindjes të të gjithë kandidatëve të vet;

6.2. adresat e kandidatëve, ashtu siç figurojnë në Regjistrin Civil;

6.3. numrat e telefonave të kandidatëve, kur ka të tillë në dispozicion;

6.4. numrat personal të identifikimit;

6.5. librezat e nënshkrimeve, në formularin i cili është bashkëngjitur, Shtojca II - Libreza e nënshkrimeve (forma fizike dhe elektronike), të siguruar nga Zyra.

7. Subjektet politike, në aplikimin për certifikim, duhet të përfshijë librezat e nënshkrimeve, në formularin i cili është bashkëngjitur, në formë fizike dhe elektronike, Shtojca II – Libreza e nënshkrimeve (në formën fizike dhe elektronike), që përmban:
 - 7.1. njëqind (100) nënshkrime të vlefshme të përkrahjes së votuesve të regjistruar për secilën komunë në të cilën subjekti politik ka për qëllim të garojë. Në rast se ka për qëllim që të garojë në dhjetë ose më shumë komuna, atëherë numri i nënshkrimeve duhet të jetë të paktën njëmijë (1,000) nënshkrime.
 - 7.2. njëmijë (1,000) nënshkrime të vlefshme, nëse ka për qëllim të garojë në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.
8. Personi mund të jep nënshkrimin e tij/saj në mbështetje të vetëm një subjekti politik për ato zgjedhje.
9. Llojet e nënshkrimeve në vijim konsiderohen si të pavlefshme dhe në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në paragrafin 7, nën paragrafi 7.1 dhe 7.2 të këtij neni:
 - 9.1. Nënshkrimet e personave të cilët nuk janë votues të regjistruar;
 - 9.2. nënshkrimet e mbështetjes për të cilat çfarëdo informate e kërkuar mungon, apo është e palexueshme;
 - 9.3. nënshkrimet të cilat janë me të njëjtin dorëshkrim si nënshkrimet tjera, përfshirë nënshkrimet nga udhëheqësi i familjes për anëtarët e tjerë të familjes;
 - 9.4. nënshkrimet të cilat përfshijnë informata të cilat nuk përputhen me informatat e regjistruara në variantin e fundit të listës së votuesve;
 - 9.5. në rast kur nënshkrimet e personave të cilët tanimë kanë nënshkruar në përkrahje të më shumë se një subjekti politik brenda një procesi zgjedhor, nënshkrimi i dhënë për subjektin i cili i pari e dorëzon dokumentacionin, është valid.
10. Subjekti politik që ka marr së paku një (1) ulëse në Kuvendin e Kosovës, nuk kërkohet të dorëzojë nënshkrimet në mbështetje të aplikimit për certifikim në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe zgjedhjet lokale dhe nuk obligohet të bëjë pagesën e certifikimit.
11. Subjekti politik që nuk ka ulëse në Kuvendin e Kosovës, mirëpo ka së paku një (1) anëtar në kuvendin komunal, nuk kërkohet të dorëzojë nënshkrimet në mbështetje të aplikimit për certifikim në zgjedhjet lokale për atë komunë, dhe nuk obligohet të bëjë pagesën e certifikimit.
12. Nëse dy e më shumë subjekte politike të përfaqësuara në kuvendin e Republikës së Kosovës ose në kuvendin komunal përkatës, aplikojnë për certifikim si koalicion, nuk iu kërkohet të dorëzojë nënshkrimet në mbështetje të aplikimit për certifikim dhe nuk obligohen ta bëjnë pagesën e certifikimit.

13. Dëftesën bankare të taksës për aplikim që dëshmon se subjekti politik që ka aplikuar për t'u certifikuar, e ka paguar depozitën e certifikimit në shumë:

13.1. Njëqind (100) euro, për secilën komunë që ka për qëllim të garojë;

13.1.1. Në rast se ka për qëllim që të garojë në pesë ose më shumë komuna, atëherë pagesa e certifikimit është 500 euro.

13.2. njëmijë (1,000) euro, nëse ka për qëllim të garojë në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës;

13.3. Njëmijë e pesëqind (1,500) euro, nëse ka për qëllim të garojë në zgjedhjet për kuvend komunal dhe për Kuvendin e Kosovës.

Neni 3

Kriteret për listën e kandidatëve

1. Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik, së paku tridhjetë për qind (30%) janë burra dhe së paku tridhjetë për qind (30%) janë gra: me nga një kandidat të secilës gjini, në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë. Kjo nuk aplikohet te listat e përbëra me nga një, apo dy kandidatë. Subjekti politik që nuk është kandidat i pavarur, e paraqet listën e kandidatëve në përputhje me nenin 30 të LZP dhe Rregulloret e KQZ.
2. Numri i kandidatëve në një listë të një subjekti politik, nuk mund të përmbajë më shumë se 10% e maksimumit të numrit të ulëseve të caktuara në kuvendin për të cilin ka për qëllim të garojë.
3. Kandidatët në listën e subjektit politik mund të aplikojnë për zgjedhjet në të gjitha nivelet, vetëm në emër të një subjekti politik.
4. Për zgjedhjet për kryetar komune, në rast se kandidati nuk ka qenë votues në zgjedhjet paraprake në komunën ku kandidon, dorëzon dëshminë që ka jetuar në atë komunë për të paktën tri vjet. Dëshmia duhet të jetë e lëshuar nga institucionet publike.
5. Secili kandidat duhet të plotësojë formularin e aplikimit për certifikim të kandidatit, shtojca VI - Formulari për aplikim për certifikim të kandidatit dhe t'a nënshkruajë atë si konfirmim se:
 - 5.1. nuk mban asnjë post që e pamundëson atë për t'u certifikuar si kandidat bazuar në nenin 30 të LZP
 - 5.2. ai/ajo jep pëlqimin të paraqitet si kandidat për subjektin politik, në listën e të cilit ai/ajo paraqitet;
 - 5.3. ai/ajo zotohet të veprojë në përputhje me LZP, Rregulloret e KQZ, dhe Kodin e Mirësjelljes.

Neni 4

Shqyrtimi i aplikacioneve për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre

1. Zyra pranon kërkesën për certifikim në prani të përfaqësuesit të subjektit politik dhe ia jep dëftesën me të cilën dëshmohet data e dorëzimit.
2. Zyra shqyrton secilën kërkesë për certifikim dhe të konstatojë nëse:
 - 2.1. Formulari i aplikimit të kërkesës për certifikim të subjektit politik është plotësuar saktë dhe në mënyrë të plotë;
 - 2.2. dokumentacioni përcjellës është i plotë dhe se nënshkrimet në librezën e nënshkrimeve janë të vlefshme dhe të mjaftueshme;
 - 2.3. listën e kandidatëve të subjektit politik për secilin proces zgjedhor në të cilën garohet, e cila është bashkëngjitur, shtojca V - Lista e kandidatëve të subjektit politik, të shtypur dhe të nënshkruar nga kryetari i subjektit politik ose personi kontaktues, si edhe në formën elektronike siç përshkruhet në këtë Rregullore;
 - 2.4. formularin i aplikimit për certifikim të kandidatit, shtojca VI - Formulari për aplikim për certifikim të kandidatit.
3. Zyra shqyrton dokumentacionin e pranuar, për secilin subjekt politik dhe kandidat që paraqiten në listën e renditur të kandidatëve të subjektit politik, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj Rregulloreje.
4. Zyra bënë verifikimin e secilës kërkesë për certifikim dhe të konstatojë nëse të gjithë kandidatët që paraqiten në listën e kandidatëve:
 - 4.1. Janë votues me zotësi juridike nëse garojnë në zgjedhje për Kuvendin e Kosovës;
 - 4.2. janë votues me zotësi juridike të regjistruar në komunën në të cilën kanë për qëllim të garojnë për zgjedhjet komunale;
 - 4.3. janë votues me zotësi juridike nëse garojnë për kryetar komune dhe së paku tre (3) vite duhet të jenë banor të komunës, në të cilën ai apo ajo është duke garuar për t'u zgjedhur si kryetar komune;
 - 4.4. paraqiten në listën e kandidatëve të vetëm një subjekti politik.
5. Zyra nëpërmjet institucioneve tjera përkatëse bënë verifikimin e secilës kërkesë për certifikim dhe të konstatojë nëse të gjithë kandidatët që paraqiten në listën e kandidatëve, përmbushin të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 30 të LZP.
6. Zyra do të krijojë bazë të të dhënave të personave që përkrahin aplikimin e secilit subjekt politik, që duhet të përmbushë këto kritere:

- 6.1. baza e të dhënave do të përmbajë: emrin, mbiemrin, datën e lindjes, adresën e banimit, numrin personal të identifikimit;
- 6.2. baza e të dhënave mund të përdoret vetëm për qëllim të kontrollimit të dhënave të dyfishta;
- 6.3. baza e të dhënave duhet të fshihet në përfundim të procesit të certifikimit.
7. Zyra i shqyrton të gjitha aplikimet për certifikim dhe, nëse konstaton se subjekti politik nuk ka plotësuar të gjitha kërkesat, brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimit të aplikimit për certifikim, dërgon një njoftim me të cilin e informon subjektin politik për arsyen pse aplikimi nuk është në rregull.
8. Subjekti politik i cili pranon njoftimin nga Zyra, siç përcaktohet në paragrafi 6 të këtij neni, ka pesë (5) ditë për të dorëzuar në Zyre aplikimin e korrigjuar.
9. Pasi subjekti politik e dorëzon aplikacionin e korrigjuar siç përshkruhet në nenin 2 të kësaj Rregulloreje, Zyra i bën rekomandim me shkrim KQZ, për ta miratuar ose refuzuar brenda (5) ditëve nga pranimi i dokumentacionit të plotë.
10. Pas pranimit të rekomandimit nga Zyra, KQZ e miraton ose refuzon aplikimin për certifikim brenda shtatë (7) ditëve.
11. Pas vendimit të KQZ, Zyra e njofton menjëherë aplikuesin me shkrim rreth statusit të aplikimit dhe, në rast të refuzimit, ofron arsyetimin për refuzim dhe e këshillon aplikuesin për të drejtën e tij për t'u ankuar në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga njoftimi.
12. KQZ i publikon listat e certifikuara të kandidatëve në afat brenda njëzet e katër (24) orëve pas certifikimit.
13. Zyra duhet ketë librin e protokollit, i cili përmban të gjitha kërkesat e pranuar për certifikim, datat e dorëzimit dhe të ridorëzimit të ndryshimeve në ato kërkesa, nga secili subjekt politik.

Neni 5

Tërheqja apo zëvendësimi i kandidatëve dhe subjekteve politike

1. Subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor, duke i dorëzuar KQZ një njoftim me shkrim, me të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje, jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje.
2. Nëse kandidati vdes para zgjedhjeve, subjekti i certifikuar politik mund ta zëvendësojë atë dy (2) ditë para datës së caktuar për tërheqjen e shortit.
3. Në rast se PZAP largon një kandidat nga lista e kandidatëve, pas përcaktimit se kandidati nuk ka dhënë pëlqimin e tij/saj për t'u emëruar si kandidat, subjekti politik nuk mund ta

zëvendësojë atë kandidat në listën e kandidatëve, por siguron që lista të jetë në përputhje me nenin 3 të kësaj Rregulloreje.

4. Duke mos paragjykuar dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, një subjekt politik, nismë qytetare apo koalicion mundet që katër (4) ditë pas largimit të kandidatit, por jo më vonë se 2 ditë para certifikimit, ta zëvendësojë atë nëse ai kandidat në të njëjtën kohë paraqitet në listën e kandidatëve të një subjekti tjetër politik, nismë qytetare ose koalicioni dhe shpreh synim të qartë me shkrim se do të mbetet në listën e subjektit tjetër politik.
5. Të gjitha kërkesat, bazuar në nenin 29 të LZP, për të tërhequr një kandidat të certifikuar nga zgjedhjet, dorëzohen në KQZ.

Neni 6

Ruajtja dhe verifikimi i të dhënave të kandidatëve

1. Zyra do të mbajë në konfidencë të gjitha informacionet rreth kandidatëve, të dorëzuara tek KQZ, në pajtim me Rregulloret, LZP dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, deri pas certifikimit të kandidatit nga ana e KQZ, përveç rasteve kur Zyra do t'u ofrojë agjencive për zbatimin e ligjit secilin informacion të nevojshëm, me qëllim të sigurisë gjatë procesit të zgjedhjeve.
2. Në rast se KQZ nuk certifikon një kandidat, Zyra nuk i zbulon të dhënat personale të atij kandidati.

Neni 7

Pagesa e certifikimit

1. KQZ ka një xhironlogari bankare në emër të KQZ, e cila do të përdoret për grumbullimin dhe refundimin e pagesave të certifikimit. Detajet e xhironlogarisë bankare janë në faturën e pagesës.
2. Depozitat e certifikimit, i barten Buxhetit të Kosovës.

Neni 8

Renditja në fletëvotim

1. Shorti i renditjes të subjekteve politike në fletëvotim mbahet në një datë të caktuar nga KQZ, jo më vonë se tridhjetë e dy (32) ditë para ditës së zgjedhjeve.

2. Kryesuesi i KQZ vendos për procedurat që duhen respektuar gjatë tërheqjes së shortit, duke siguruar se tërheqja është e drejtë dhe transparente. Kryesuesi i KQZ e kryeson tërheqjen e shortit.
3. Zyra i njofton subjektet politike për vendndodhjen, datën dhe kohën në të cilën shorti i renditjes në fletëvotim do të mbahet. Secili subjekt politik dërgon një përfaqësues për të tërhequr shortin dhe për të vëzhguar. Në rast se subjekti politik nuk e dërgon përfaqësuesin e vet, një anëtar i KQZ/SKQZ e tërheq shortin për atë subjekt.
4. Kryesuesi dhe zëdhënësi i KQZ moderon ceremoninë e tërheqjes së shortit për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim.
5. Në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, numri më i vogël për tërheqje me qëllim të renditjes në fletëvotim, do të jetë numri 111.
6. Në zgjedhjet për kuvendet e komunave, numri më i vogël për tërheqje me qëllim të renditjes në fletëvotime, do të jetë numri 100.
7. Renditja në fletëvotim përmes shortit do të zhvillohet sipas metodës në vijim:
 - 7.1. Emrat e secilit subjekt politik të certifikuar do të shtypen në letër, secila vec e vec, të cilat futen në topa të mbyllur dhe vendosen në një vazo (Vazo I – Emrat e subjekteve politike të certifikuar);
 - 7.2. numrat do të shtypen në letër, duke filluar nga numri më i vogël, sipas paragrafit 5 respektivisht 6 të këtij neni, deri te numri më i madh, për aq sa ka subjekte politike të certifikuar, të cilat vendosen në topa të veçantë, që vendosen në një vazo (Vazo II – numrat e subjekteve politike të certifikuar);
 - 7.3. tërheqja e topave nga vazot, bëhet si në vijim:
 - 7.3.1. tërhiqet topi nga vazo me emrat e subjekteve politike të certifikuar, i cili u shfaqet dhe i lëxohet pjesëmarrësve, dhe pastaj, tërhiqet topi nga vazo që përmban numrat rendor, i cili u shfaqet dhe i lëxohet pjesëmarrësve;
 - 7.3.2. lexohet emri i subjektit politik të certifikuar me numrin rendor;
 - 7.3.3. stafi i Zyrës dhe i Sekretariatit të KQZ, mban të dhënat e subjekteve politike të certifikuar me numrat, sipas tërheqjes së shortit.

Neni 9

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla Zgjedhore Nr.04/2023 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre.

2. Pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje janë edhe shtojcat:
 - 2.1. shtojca I – Kërkesë për certifikim të subjektit politik;
 - 2.2. shtojca II – Libreza e nënshkrimeve (forma fizike dhe elektronike);
 - 2.3. shtojca III – Formulari i pëlqimit të koalicionit;
 - 2.4. shtojca IV – Lista e kandidatëve të koalicionit (forma fizike dhe elektronike)
 - 2.5. shtojca V – Lista e kandidatëve të subjektit po (forma elektronike);
 - 2.6. shtojca VI – Formulari për aplikim për certifikim i kandidatit;
 - 2.7. shtojca VII – Deklarata për respektimin e kodit të mirësjelljes;
 - 2.8. shtojca VIII – Deklarata politike.
3. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, Zyra obligohet që ta hartojë procedurën për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre.
4. Procedura e aplikimit dhe shqyrtimit të kërësave për certifikim, si dhe proceseve tjera të parapara me këtë rregullore, përshtaten në platformën elektronike të KQZ.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi